

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/ekspertet-zbulojne-shtate-sjellje-te-cuditshme-qe-mund-te-li-dhen-me-int-i474160
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:59:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bd111f49ec85b952d9c7cf23ce092b11dc493cfbe44b8cf554e58341bd9b4b6
TEKSTI	de7fe93fae3d6615a7fe8170967c3a104fca948798b9ca86e31398ea286d09d6
PAMJA	b04b0365253d9bc618be08d963bba22892aa8605dac994f1c371ae36eaa3b41a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b549ee79bb9f9a7d01588d5c8c87732283e13d11468a9b6377a5420982586ceb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b549ee79bb9f9a7d01588d5c8c87732283e13d11468a9b6377a5420982586ceb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë



14 Shtator 2026, 20:44, Opinione Albert Vataj



Disa nga mendjet më të mëdha të historisë, si Albert Einstein dhe Charles Darwin, njiheshin për zakone dhe mënyra sjelljeje që, në sytë e të tjerëve, mund të dukeshin të pazakonta: vetmia, puna deri vonë, zhytja në mendime apo përkushtimi i jashtëzakonshëm ndaj leximit dhe kërkimit.

Por ajo që dikur mund të konsiderohej thjesht si "çuditshmëri", në dritën e disa studimeve psikologjike dhe neuroshkencore mund të lidhet me mënyra të veçanta të funksionimit njohës. Sjelljet e përditshme ndikojnë në mënyrën se si përqendrohemi, përpunojmë informacionin, krijojmë ide dhe ndërtojmë njohuri.

Psikologët dhe studiuesit kanë identifikuar një sërë prirjesh që, në rrethana të caktuara, shfaqen më shpesh te njerëzit me aftësi të larta njohëse ose krijuese.

Kjo nuk do të thotë se kushdo që shfaq këto sjellje ka domosdoshmërisht një IQ të lartë. Inteligjenca është një dukuri shumë më komplekse sesa një numër i vetëm në një test. Megjithatë, disa prej këtyre zakoneve janë veçanërisht interesante për mënyrën se si lidhen me kujtesën, përqendrimin, kreativitetin dhe përpunimin e informacionit.

Më poshtë janë shtatë prej tyre.

1. Të flasësh me veten

Nëse e gjeni veten duke folur me zë të lartë me veten, kjo nuk do të thotë se “jeni i çmendur”. Përkundrazi, në rrethana të caktuara, të folurit me veten mund të jetë një mjet i dobishëm për organizimin e mendimit.

Një numër në rritje studimesh sugjeron se të folurit me veten mund të ndihmojë në kujtesë, përqendrim, orientim të vëmendjes dhe zgjidhjen e problemeve.

Në një studim të vitit 2012, studiuesit u paraqitën pjesëmarrësve fotografi të objekteve të ndryshme dhe u kërkuan të identifikonin një objekt të caktuar. Rezultatet sugjeruan se ata që flisnin me veten gjatë kërkimit mund ta identifikonin objektin më shpejt.

Një tjetër studim, i realizuar në vitin 2017 nga studiues në Mbretërinë e Bashkuar, shqyrtoi marrëdhënien mes të folurit të brendshëm dhe mënyrës se si truri përpunon informacionin pamor dhe dëgjimor.

Në eksperiment, pjesëmarrësve iu kërkua të përsërisnin me zë të lartë tinguj të pakuptimtë, si “blah-blah-blah”, ndërkohë që kryenin detyra të ndryshme vizuale dhe dëgjimore. Kjo pengonte përdorimin e të folurit të brendshëm për të drejtuar veprimet.

Paloma Mari-Beffa, pedagoge e lartë në Universitetin Bangor, ka shpjeguar se të folurit me veten mund të funksionojë si një mënyrë për t’i dhënë trurit udhëzime dhe për të organizuar sjelljen.

Pra, herën tjetër që dikush t’ju kapë duke mëmëritur me veten, mos u turpëroni. Ndonjëherë, ajo që duket si një zakon i çuditshëm mund të jetë thjesht një mënyrë për të menduar më qartë.

2. Të qëndrosh zgjuar deri vonë

A jeni nga ata njerëz që ndihen më aktivë kur nata ka rënë dhe pjesa tjetër e botës ka fjetur?

Disa kërkime kanë gjetur një lidhje interesante mes prires për të qëndruar zgjuar deri vonë dhe aftësive të caktuara njohëse.

Një studim i publikuar këtë vit, që analizoi të dhëna nga rreth 26 mijë të rritur, raportoi se njerëzit me kronotipe më të vona, pra ata që priren të jenë më aktivë gjatë orëve të vona, kishin rezultate më të mira në disa teste të funksioneve njohëse sesa ata me prije të theksuar për t’u zgjuar herët.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se pagjumësia apo mungesa e gjumit e rrit inteligjencën. Përkundrazi, gjumi cilësor është thelbësor për funksionimin e trurit.

Ajo që mund të jetë interesante është se disa njerëz kanë një ritëm natyror të ndryshëm të aktivitetit mendor. Shumë figura të njohura të kulturës dhe shkencës, përfshirë Charles Darwin dhe Marcel Proust, njiheshin për orare pune që shkonin thellë në natë.

Nëse mendja juaj ndizet kur qyteti bie në qetësi, kjo mund të jetë thjesht mënyra juaj individuale e funksionimit.

3. Të ëndërrosh me sy hapur

Të humbasësh në mendime shpesh interpretohet si shpërqendrim apo mungesë vëmendjeje. Por jo gjithmonë është kështu.

Disa kërkime sugjerojnë se endja e mendjes mund të lidhet me kreativitetin, përpunimin kompleks të informacionit dhe aftësinë për të krijuar lidhje të reja mes ideve.

Eric Schumacher, profesor i asociuar i psikologjisë në Georgia Tech, ka argumentuar se njerëzit me tru më efikas mund të jenë në gjendje të lejojnë mendjen të endet pa humbur plotësisht kontrollin mbi detyrën.

Në një studim të lidhur me këtë fushë, pjesëmarrësit që raportonin më shumë “endje të mendjes” shfaqën rezultate më të larta në disa teste të aftësive intelektuale dhe krijuese. Skanimet e trurit sugjeruan gjithashtu dallime në mënyrën se si funksiononin disa rrjete cerebrale.

Kjo e bën “ëndërrimin me sy hapur” një dukuri më komplekse sesa duket. Ndonjëherë mendja nuk po largohet nga realiteti; ajo mund të jetë duke ndërtuar një tjetër rrugë drejt tij.

4. Të lulëzosh në rrëmuje

Disa njerëz nuk mund të mendojnë pa pasur gjithçka të sistemuar në mënyrë perfekte. Të tjerë punojnë më mirë mes librave të hapur, letrave, objekteve dhe një tavoline që për syrin e dikujt tjetër mund të duket kaotike.

Një studim i njohur mbi mjediset e rregullta dhe të çrregullta shqyrtoi pikërisht këtë marrëdhënie. Pjesëmarrësit u vendosën në hapësira të rregullta ose të çrregullta dhe iu kërkua të mendonin për përdorime të reja për topat e ping-pongut.

Të dy grupet prodhuan një numër të ngjashëm idesh, por pjesëmarrësit që ndodheshin në mjedisin e çrregullt gjeneruan ide që studiuesit i vlerësuan si më kreative.

Kathleen Vohs, një nga studiueset kryesore të eksperimentit, ka argumentuar se mjediset e çrregullta mund t’i nxisin njerëzit të çlirohen nga normat tradicionale dhe të kërkojnë mënyra të reja të të menduarit.

Ndërsa mjediset e rregullta priren të nxisin rendin dhe respektimin e konvencioneve, një hapësirë më kaotike mund të krijojë terren për spontanitet dhe eksplorim.

Pra, një tavolinë e çrregullt nuk është domosdoshmërisht shenjë e një mendjeje të çorganizuar. Në disa raste, mund të jetë hapësira ku imagjinata ndihet më e lirë.

5. Të bësh shumë pyetje

“Pse?”, “Si?”, “Nga vjen?”, “Çfarë do të ndodhte nëse...?”

Në dukje, pyetjet e pafundme mund të jenë bezdisëse. Por pas tyre fshihet një prej motorëve më të fuqishëm të inteligjencës: kurioziteti.

Njeriu që pyet vazhdimisht nuk është domosdoshmërisht i kënaqur me përgjigjen e parë. Ai kërkon të depërtojë më thellë, të kuptojë mekanizmin, shkakun dhe pasojën.

Kurioziteti nxit eksplorimin, mësimin dhe grumbullimin e informacionit. Sa më shumë pyetje të bëjë një njeri, aq më shumë mundësi krijon për të zgjeruar horizontin e vet njohës.

Për këtë arsye, kurioziteti është shpesh i lidhur me kreativitetin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Albert Einstein i atribuohen fjalët: “Unë nuk kam talent të veçantë. Jam vetëm kureshtar me pasion.”

Dhe ndoshta këtu qëndron një nga sekretet e mendjeve të mëdha: ato nuk pushojnë së pyeturi.

6. Të jesh introvert

Historia e mendimit është e mbushur me njerëz që kanë kërkuar vetminë për të menduar, shkruar, lexuar apo krijuar.

Introversioni nuk është sinonim i inteligjencës, por disa tipare që shoqërojnë introversionin, si preferenca për vetminë, përqendrimin e gjatë dhe reflektimin, mund të krijojnë kushte të favorshme për punë të thelluar intelektuale.

Njerëzit më introvertë mund të preferojnë aktivitete që kërkojnë përqendrim të qëndrueshëm, si leximi, kërkimi, shkrimi apo zgjidhja e problemeve komplekse.

Megjithatë, është e rëndësishme të bëhet dallimi: nuk ka një rregull shkencor që thotë se introvertët kanë IQ më të lartë se ekstrovertët. Personaliteti dhe inteligjenca janë dimensione të ndryshme.

Ajo që mund të ketë rëndësi është aftësia për të qëndruar gjatë në një ide pa pasur nevojë për stimulim të vazhdueshëm nga jashtë.

7. Të gllabërosh libra

Nëse e gjeni veten vazhdimisht me hundën në një libër, mund të jeni duke i dhënë trurit një prej ushtrimeve më të fuqishme intelektuale.

Leximi na ekspozon ndaj fjalëve të reja, ideve komplekse, këndvështrimeve të ndryshme dhe mënyrave të reja për të interpretuar botën.

Ai mund të ndihmojë në zhvillimin e fjalorit, përqendrimin, imagjinatën dhe aftësisë për të kuptuar perspektivat e të tjerëve.

Leximi i letërsisë, në veçanti, është lidhur në studime të ndryshme me aftësinë për të kuptuar gjendjet mendore dhe emocionale të njerëzve të tjerë.

Një shembull i famshëm është Warren Buffett, i cili ka deklaruar se kalon një pjesë shumë të madhe të ditës duke lexuar dhe studiuar.

Por rëndësia nuk qëndron vetëm te numri i librave që lexojmë. Ajo që ka vlerë është mënyra se si lexojmë: nëse ndalemi, pyesim, krahasojmë, kundërshtojmë, reflektojmë dhe i lidhim idetë e librit me përvojën dhe njohuritë tona.

Në fund të fundit, një libër nuk e bën automatikisht askënd më të zgjuar. Por një mendje që lexon, pyet dhe reflekton vazhdimisht i jep vetes më shumë mundësi për t'u zhvilluar.


Inteligjenca nuk duket gjithmonë siç e imagjinojmë

Ndoshta ajo që i bashkon këto shtatë sjellje nuk është "çuditshmëria" e tyre, por fakti se ato na kujtojnë diçka më të rëndësishme: mendja njerëzore nuk funksionon gjithmonë sipas rregullave të dukshme të normalitetit.

Të flasësh me veten mund të jetë një mënyrë për të organizuar mendimin. Të humbasësh në ëndrra mund të jetë një udhëtim drejt një ideje të re. Të bësh pafundësisht pyetje mund të jetë mënyra më e mirë për të mësuar. Vetmia mund të krijojë hapësirë e nevojshme për reflektim, ndërsa një libër mund të hapë një botë të tërë brenda nesh.

Prandaj, para se ta quajmë dikë "të çuditshëm", ndoshta duhet të pyesim veten nëse ajo çuditshmëri nuk është thjesht një formë tjetër e të menduarit.

Inteligjenca nuk është gjithmonë zhurmë, shpejtësi apo spektakël. Shpesh ajo shfaqet si kuriozitet, përqendrim, vetmi, imagjinatë dhe një dëshirë e pashtershme për të kuptuar atë që të tjerët e pranojnë pa pyetur.





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale

Keqkuptimi me takimet e së premtës!

Jo kundër Muzeut Hebraik në Vlorë, por kundër histerisë rreth tij

Kush është Ron Yeffet dhe çfarë pushteti ka në Shqipëri?

GJYSH, TË FALËM!

"Timak Defence", para se të kërcënoni median, tregoni se çfarë bëni

Azem Hajdari

Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

Nga zv/ministër i guriçkave në dallkauk, haxhiqamelist

Një propozim modest për protestuesit

FEMINIZMI SI ALIBI

Përpara pasqyrës apo iluzionit mashtrues?

Lajmi është që Ukraina i blen makinat dhe armët me tendera!

Shqipëria në shitje dhe Masakra e Koplikut si tradhti kombëtare

Inteligjenca Artificiale dhe teknologjia tek fëmijët

Prania Besnike e Zeqinesë!

Bilanci njëvjeçar i Diellës

Kali i Kaligulës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.